

L I G J
Nr.9581, datë 13.7.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8982, DATË 12.12.2002 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës “ç” të nenit 8 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:
“d) taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;”.

Neni 2

Pas nenit 16 shtohen nenet 17 e 18 me këtë përmbajtje:

“Neni 17

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

3. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e çdo muaji.

Neni 18

Përrjashtime nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";

c) subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përjashtimin nga taksa. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Për rastet kur pranohet nga vetë palët ose vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjit."

Neni 3

Neni 25/1 "Dispozita të përkohshme" shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4997, datë 25.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKSI 3

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë e ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m ²			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
II. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për bashkitë.

Shënim II: Të gjitha komunat zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3 të bashkive.